

NOTE INFORMATIVE

Tiranë, më 16.06.2023

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Shkarkim nga detyra” ndaj prokurorit S.H..

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar hetimin disiplinor *me iniciativë* ndaj veprimtarisë së magjistratit S.H. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nga neni 104 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor ndaj prokurorit S.H., rezulton se:

- Magjistrati është gjetur fajtor nga Gjykata e Posaçme Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për kryerjen e veprës penale të “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, dhe “Refuzimi për deklarimin ose mos deklarimi i pasurisë, interesave private të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër, që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe është dënuar me 2 vjet e 4 muaj burgim.
- Nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor, rezulton se janë ndërmarrë veprime, të cilat janë vlerësuar se përmbajnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 319/ç i K.Penal, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe me qëllim përfitim të padrejtë prej saj, duke favorizuar një palë ndërgjyqëse nëpërmjet dhënies së vendimit. Rezulton se vepra penale është kryer me dashje direkte “*edhe pa u realizuar konkretisht një shkëmbim parash apo shpërblim në përfitime të tjera mes dy palëve, pasi mjafton që të arrihet një marrëveshje(pactum sceleris) në formë premtimi për përfitime të parregullta të dyanshme, edhe pa marrjen e kontaktit të drejtpërdrejtë mes palëve, mjafton që funksionari i lartë i drejtësisë(përfshirë gjyqtar dhe prokuror) të ketë dijeni rreth saj dhe marrëveshja korruptive mund të bazohet edhe nga fakte përmbyllëse*”.
- Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara, duke mbajtur në konsideratë natyrën e shkeljes disiplinore, ajo e kryerjes së një krimi për të cilin është dënuar me vendim të formës së prerë, dhe faktin që shkelja disiplinore në rastin konkret përbën “*Shkelje shumë të rëndë disiplinore*”; provohet se magjistrati S.H. ka diskredituar ka diskredituar rëndë figurën, autoritetin, dinjitetin e magjistratit dhe ka ulur besimin e publikut tek dhënia e drejtësisë.

Për sa më sipër, kërkohet nga Këshilli i Lartë të Prokurorisë pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore “*Shkarkim nga detyra*” për prokurorin S.H. të parashikuar nga neni 148/d, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga nenet 111 të ligjit nr. 96/ 2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.